

Rregullore e organizimit

të studentëve e

Akademisë “Evolucion”

Prishtinë

2018

Në bazë të Statutit të Akademisë "Evolucion" (në tekstin e mëtejshëm: "AE"), Bordi i Drejtorëve (në tekstin e mëtejshëm "BiD") i Akademisë "Evolucion" në seancën e mbajtur në Prishtinë më 20.12.2018 miraton këtë:

RREGULLORE TË ORGANIZIMIT TË STUDENTËVE E AKADEMISË "EVOLUCION"

Misioni i organizimit të studentëve

Neni 1

Bordi i Drejtorëve të Akademisë "Evolucion" (AE) përkrah formimin e organizatës së studentëve. Misioni i organizatës është që studentët, me pjesëmarrje e tyre aktive, të japin kontribut të çmuar për përvojën e tyre arsimore.

Këshilli i Studentëve

Article 2

1) Organizata e studentëve quhet Këshilli i Studentëve të Akademisë "Evolucion" (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli i Studentëve).

2) Këshilli i Studentëve do të ketë selinë në ndërtesën e Akademisë "Evolucion".

3) Qëllimet e Këshillit të Studentëve janë:

1. Të ndihmojë çdo student të mësojë se si të arrijë misionin e Akademisë "Evolucion";
2. Të ndihmojë në përmirësimin e komunikimit ndërmjet studentëve dhe Akademisë përmes miqësisë dhe besimit mbi interesat e përbashkëta;
3. Të promovojë unitetin e studentëve përmes ndihmës së klubeve, grupeve të vogla dhe shërbimeve.

Anëtarësia

Neni 3

1) Anëtarë të Këshilli të Studentëve kanë të drejtë të jenë studentët e zgjedhur nga secili departament që plotësojnë këto kushte:

- të jenë student/e të rregullt/a,

- të jenë të gatshëm/e të shërbejnë duke u përfshirë në aktivitetet dhe projektet e AE dhe duke respektuar dhe mbështetur misionin e AE.

2) Të gjithë anëtarët duhet të respektojnë rregulloret e Këshillit të Studentëve.

Zyrtarët e Këshillit të Studentëve

Neni 4

1) Këshilli i Studentëve do të ketë këta zyrtarë:

1. Kryetarin dhe nënkryetarin,
2. Sekretarin.

2) Përgjegjësia e zyrtarëve të Këshillit të Studentëve është si vijon:

- a. Kryetari përfaqëson Këshillin e Studentëve dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet e përgjithshme;
- b. Nënkryetari ndihmon kryetarin, planifikon dhe promovon çështjet e Këshillit si dhe përfaqëson këshillin në mungesë të kryetarit;
- c. Sekretari është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin, shpalljet dhe kontabilitetin;

3) Mandati i zyrtarëve të Këshillit të Studentëve është dy vite akademike.

4) Anëtar i Këshillit të Studentëve, pa të drejtë vote, është edhe përfaqësuesi i AE i ngarkuar me çështjet studentore.

Mbledhjet

Neni 5

1) Mbledhjet e Këshillit të Studentëve mbahen si në vijim dhe thirren nga kryetari:

1. Mbledhja e Përgjithshme Vjetore - mbahet në muajin janar të çdo viti dhe mbledhja lajmërohet së paku dy javë para mbajtjes së saj. Gjatë kësaj mbledhjeje trajtohen çështjet në vijim;
 - a) Paraqitja e Raportit vjetor të veprimtarisë dhe shpenzimeve;
 - b) Aprovimi dhe ndryshimi i rregulloreve të Këshillit;

- c) Zgjedhja e Kryetarit dhe përfaqësuesve të tjerë të Këshillit në organet e Akademisë;
- d) Tjera.

2. Mbledhja e thirrur:

- a) Mbledhja e thirrur mbahet sipas nevojës dhe mbajtja e mbledhjes vendoset me kërkesën e Presidentit;
- b) Mbajtja e mbledhjes së thirrur shpallet së paku një javë më parë.

3) Gjatë mbledhjeve, të gjitha vendimet, me përjashtim të ndryshimit të akteve nënligjore, merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.

Zgjedhjet

Neni 6

- 1) Të gjithë anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen.
- 2) Të drejtë për t'u zgjedhur si Kryetar kanë anëtarët e Këshillit, që kanë statusin e studentit të Akademisë për të paktën një vit.
- 3) Kryetari dhe zyrtarët e tjerë të Këshillit zgjidhen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote.

Financimi

Neni 7

- 1) Financimi i Këshillit bëhet nga anëtarësia e studentëve dhe nga donacionet.
- 2) Shumën e anëtarësisë e propozon BD i Akademisë.
- 3) Shfrytëzimi i mjeteve financiare vendoset në mbledhjen e Këshillit.
- 4) Auditimet e shfrytëzimit të mjeteve financiare të Këshillit bëhen nga BD i AE, rregullisht ose herë pas here.


Rregulla shtesë

Neni 8

Statuti, rregulloret dhe aktet tjera të Këshillit hyjnë në fuqi nga data e marrjes së vendimit nga Mbledhja e Përgjithshme Vjetore. Për miratim apo ndryshim të çdo akti është i nevojshëm një votim prej dy të tretave nga anëtarët e pranishëm të Këshillit me të drejtë vote.

Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20.12.2018.

Kryesues i BiD

Besnik Shatri
